



# Formulari i regjistrimit të popullsisë dhe banesave

## Udhëzues për plotësimin e formularit

### Regjistrimi i popullsisë dhe banesave

Ky udhëzues do t'ju ndihmojë ju për të plotësuar formularin që ju është dërguar me postë. Është e rëndësishme që ju të plotësoni dhe të na dorëzoni mbrapsht formularin në *gjuhën norvegjeze*, dhe jo këtë udhëzues. Pyetjet dhe alternativat për përgjigje janë të përkthyer në udhëzues në të njëjtën radhë dhe vendosje si në formularin në gjuhën norvegjeze që ju është dërguar me postë.

Ligji mbi statistikën shtetërore i jep të drejtë Byrosë Qëndrore të Statistikave që të kërkojë përgjigje në rastin e kërkimeve shkencore që kanë rëndësi të veçantë shoqërore. Regjistrimi i popullsisë dhe banesave është kaq i rëndësishëm sa që të gjithë ata që kanë marrë formularin janë të detyruar të përgjigjen.



**Ju mund të përgjigjeni në internet ose të plotësoni formularin letër në gjuhën norvegjeze.**

Në qoftë se ju vendosni të përgjigjeni në internet, atëhere adresa jonë është [www.ssb.no](http://www.ssb.no).

Në qoftë se ju vendosni të plotësoni formularin letër, atëhere përdorni stilolaps me ngjyrë të zezë ose blu. Në qoftë se ju shkruani diçka gabim, atëhere ju duhet ta nxini gabimin në këtë mënyrë:

Në qoftë se ju keni pyetje në lidhje me formularin, atëhere ju mund të na telefononi në numrin 800 32 032.



Ju lutemi të na përgjigjeni brenda afatit të përcaktuar në formular. Në këtë mënyrë, ne nuk kemi nevojë t'ju rikujtojmë edhe njëherë.

**1** Pyetësi ka të bëjë me banesën në të cilën ti banoje me datë **3 nëntor 2001**. Ne dëshirojmë të dimë nëse në këtë datë ti banoje në adresën që është e shkruar në formularin që të është dërguar.

Ti duhet të vendosësh një kryq në kutinë e caktuar në formular. Të përkthyer në shqip janë këto alternativa për përgjigje:

◆ Po, unë banoja në këtë adresë me datë 3 nëntor 2001.	→	Shko tek pyetja 3.
◆ Jo, por unë nuk banova këtu vetëm për një kohë të shkurtër dhe nuk kam ndërruar banesë.	→	Shko tek pyetja 3.
◆ Jo, unë banoja në një banesë tjetër për arsye shkolle ose pune pavarësisht se unë nuk kisha regjistruar ndërrimin e vendbanimit.	→	Shko tek pyetja 2.
◆ Jo, unë kam ndërruar banesë.	→	Shko tek pyetja 2.

Në qoftë se ti vendose një kryq tek përgjigjet se banoje në një vend tjetër për arsye pune ose shkolle, ose se ke ndërruar banesë, atëhere ti duhet të shkruash në pyetjen 2 edhe adresën e saktë të banesës së re.

**2** Ju lutemi, jepni sa më shumë të dhëna që keni mundësi mbi adresën në të cilën ju banonit me datë **3 nëntor 2001**. Fillo, në rreshtin e parë, me emrin e rrugës, numrin e shtëpisë dhe shkronjën, në qoftë se ka. Në rreshtin e dytë, shkruani numrin postar dhe pastaj zyrën postare. **PËRDOR SHKRONJA TË MËDHA SHTYPI.**

Në qoftë se banesa nuk ka adresë rruge, atëhere ti duhet të shkruash në rreshtin poshtë numrin e regjistrimit të tokës, numrin e parcelës dhe numrin e truallit të ndërtimit.

- 3** Pyetjet e tjera kanë të bëjnë me mënyrën se si ti banon.
- a) Në qoftë se ti ke dhënë një adresë të re në pyetjen 2, atëhere ti duhet të përgjigjesh për banesën e re.**
  - b) Të gjithë të tjerët duhet të përgjigjen për banesën e adresës që është shkruar në pyetjen 1.**

Shfleto faqen tjetër të formularit!

**4 Në çfarë banese apo apartamenti banon ti?  
Banon ti në ...**

Vendos një kryq në rreshtin e duhur të formularit. Përkthyer në shqip, janë këto alternativa për përgjigje:

◆ Një banesë për një familje, e veçuar nga banesat e tjera.
◆ Një shtëpi për fermerin, shtëpi në fermë për ish fermerin ose shtëpi tjetër që përdoret gjatë punës në fermë.
◆ Një banesë për një familje, të lidhur me banesa të tjera, banesa të ndërtuara bashkë në rresht, shtëpi me dy banesa ose shtëpi me dy njësi banimi ku mund të banojnë prindërit me një nga fëmijët e martuar.
◆ Një apartament në një pallat, në një ndërtesë për katër familje, shtëpi në formë terracash ose në një ndërtesë me shumë apartamente.
<b>Ose ti banon në ...</b>
◆ Një dhomë të marrë me qira ose garsonier me hyrje më vete.
◆ Një dhomë ose garsonier pa hyrje më vete.
<b>Ose ti banon në ...</b>
◆ Një shtëpi ose apartament të një lloji tjetër.

**5** Të gjithë ata që banojnë në një ndërtesë ose shtëpi me shumë banesa, do tu dërgohet nga Instituti shtetëror i hartave një letër me shenjën e adresës. Shenja e adresës përbëhet nga një prej shkronjave H, L, U, ose K, e ndjekur nga katër numra.

**A e ke marrë një shenjë të tillë adrese me numrin e banesës për banesën në të cilën ti banoje me datë 3 nëntor 2001?**

Në qoftë se ti e ke marrë një shenjë të tillë, atëhere ti duhet ta shkruar numrin brenda rreshtit të gjerë, ku ka vend për pesë shkronja e numra.

Në qoftë se ti nuk e ke marrë një shenjë të tillë, atëhere shko tek pyetja tjetër.

**6** Në qoftë se ti banon në një pronë ku gjenden shumë shtëpi banimi pa adresë rruge, atëhere komuna ku ti banon, duhet ti caktojë çdo shtëpie një nën-numër, përveç numrit të regjistrimit të tokës ose numrit të parcelës së tokës.

**Ju lutemi, shënojeni nën-numrin, në qoftë se e keni marrë një numër të tillë.**

Në qoftë se ti e ke marrë një numër të tillë, atëhere ti duhet ta shënosh atë në rreshtin e numrave të formularit. Në qoftë se jo, atëhere shko tek pyetja tjetër.

**7 Kur u ndërtua ndërtesa ose shtëpia në të cilën ti banon?**

Vendos një kryq në rreshtin e duhur të formularit. Në qoftë se ti nuk e di se kur u ndërtua shtëpia jote, atëhere vendos një kryq në fund poshtë, në kolonën e djathtë.

**8 A mund të tregosh më me saktësi vitin e ndërtimit?**

Në rast se ti mund të tregosh më me saktësi vitin e ndërtimit për shtëpinë tënde, atëhere shkruaje vitin në rreshtin ku ka vend për katër numra, për shembull 1984.

**9 A ka ndërtesa ose shtëpia bodrum ose nënkat?**

Vendos një kryq pranë PO-së së sipërme në qoftë se shtëpia ka bodrum. Në qoftë se jo, atëhere vendos një kryq nën JO-në. Vendos një kryq pranë PO-së së poshtme në qoftë se shtëpia ka nënkat. Në qoftë se jo, vendos një kryq nën JO-në.

**10 Sa kate ka shtëpia ose ndërtesa në të cilën banon ti?**

Vendos një kryq në rreshtin e duhur të formularit. Të përkthyer në shqip, janë këto alternativa për përgjigje:

◆ Një kat.
◆ Dy kate.
◆ Tre deri në katër kate.
◆ Pesë kate ose më shumë.

**11 Ka ashensor në ndërtesë?**

Në qoftë se ka ashensor në ndërtesën ku banon ti, atëhere vendos një kryq pranë PO-së. Në qoftë se jo, atëhere vendos një kryq pranë JO-së.

**12 Çfarë lloj marrëdhënie pronësie ose qiraje ke ti ose ju mbi shtëpinë ose apartamentin në të cilin ti banon?**

Vendos një kryq në rreshtin e duhur të formularit. Të përkthyer në shqip, janë këto alternativa për përgjigje:

**Je ti/ ju ...**

◆ Vetëpronar, vetëm ose nëpërmjet pronësisë së përbashkët me anëtarë të tjerë të familjes.
◆ Pronar përmes një kooperative banimi ose shoqërie anonime.
◆ Pronar obligacioni në një shoqëri me obligacione.

<b>Ose ti/ju merrni me qira</b>	
◆	Nga një person privat.
◆	Nga një shoqëri banesash.
◆	Nga komuna.
◆	Përmes punës/ke banesë shërbimi falas.
◆	Tjetër- trego se çfarë.

Më pas vijojnë disa pyetje mbi numrin e dhomave dhe madhësinë e shtëpisë ose apartamentit ku ti banon. Ti duhet të llogarisësh vetëm ato dhoma që i ke ti në zotërim.

- a) Në qoftë se ti jep me qira një dhomë ose garsonier, atëhere kjo nuk duhet të llogaritet.  
b) Në qoftë se ti banon në një dhomë ose garsonier, atëhere do të llogaritësh vetëm dhomën ose garsonierin.

### **13 Ka banesa kuzhinë ose vend gatimi të vetin?**

Në qoftë se banesa jote ka kuzhinë ose vend gatimi të vetin, atëhere vendos një kryq pranë PO-së. Në qoftë se jo, atëhere vendos një kryq pranë JO-së. Në qoftë se ti ke vendosur kryq pranë JO-së, ti duhet të përgjigjesh nëse ti ke të drejtë të përdorësh kuzhinë të përbashkët ose jo. Në qoftë se po, atëhere vendos një kryq pranë PO-së në rreshtin në të djathtë. Në qoftë se jo, atëhere vendos një kryq pranë JO-së.

### **14 Sa dhoma gjumi me madhësi 6 metra katrore (2m x 3m) ka banesa jote?**

Në qoftë se banesa jote nuk ka dhomë gjumi, atëhere vendos një kryq në rreshtin e sipërm pranë ASNJË. Në qoftë se banesa ka dhoma gjumi, atëhere shkruaj numrin e saktë të dhomave në rreshtin e poshtëm.

### **15 Sa dhoma banimi me madhësi 6 metra katrore ka banesa jote?**

Në qoftë se banesa jote nuk ka dhomë tjetër banimi, përveç kuzhinës, dhomës së gjumit, banjës dhe korridorit, atëhere vendos një kryq në rreshtin e sipërm pranë ASNJË. Në qoftë se banesa ka disa dhoma banimi, si për shembull, dhomë ndenjeje ose dhomë pune, atëhere shkruaj numrin e dhomave të tilla në rreshtin e poshtëm.

### **16 A e përdor ti ndonjë nga dhomat që i llogarite në pyetjen 15, vetëm për veprimtari biznesi?**

Në qoftë se banesa jote ka dhoma që përdoren për veprimtari biznesi, si për shembull riparime, lokal shitjeje ose

veprimtari të ngjashme, vendos një kryq në rreshtin e sipërm pranë PO-së. Trego më poshtë se sa dhoma të tilla ka banesa jote. Në qoftë se banesa jote nuk ka dhoma të tilla, atëhere vendos një kryq në rreshtin e poshtëm pranë JO-së.

Tani ti mund të vazhdosh në fillim të faqes tjetër.

### **17 Sa dhoma me vaskë ose dush ka në banesën tënde?**

Në qoftë se banesa jote nuk ka dhomë me vaskë ose dush, atëhere vendos një kryq në rreshtin e sipërm pranë ASNJË. Në qoftë se banesa ka dhoma me vaskë ose dush, atëhere shkruaj numrin e dhomave të tilla në rreshtin e poshtëm.

### **18a Sa e madhe është banesa jote?**

Llogarit të gjitha llojet e dhomave (edhe dhomat që përdoren si depo) që ti i ke në zotërim brenda mureve të shtëpisë ose apartamentit.

Mos llogarit:

- Baxhat në çati, në të cilat duhet të përdorësh shkallë për tu ngjitur.
- Dhomat, për të cilat ti duhet të dalësh jashtë banesës për të shkuar tek ato.
- Dhomat ose garsonierët që ti i jep me qira.

Vendos një kryq në intervalin e duhur të formularit.

### **18b A mund të tregosh më me saktësi sipërfaqen e banesës brenda intervalit ku vendose kryq tek pyetja 18a?**

Në qoftë se ti mund të tregosh më me saktësi madhësinë e sipërfaqes së banimit, atëhere shkruaj madhësinë e saktë në rreshtin ku ka vend për katër numra.

### **19 A mund një njeri me të meta fizike që përdor karrocë invalidi të hyjë në banesë me forcat e veta? Që një njeri që përdor karrocë invalidi të mund të hyjë brenda, duhet ndërmjet të tjerash që dyert e hyrjes të jenë minimumi 80 centimetra të gjera.**

Në qoftë se ti mendon se një njeri me të meta fizike që përdor karrocë invalidësh mund të hyjë brenda, atëhere vendos një kryq në rreshtin e sipërm, prapa PO-së. Në qoftë se jo, atëhere vendos një kryq tek JO-ja.

### **20 Pas hyrjes në banesë, a mundet një njeri me të meta fizike që përdor një karrocë invalidësh, të përdorë me**

### forcat e veta .....

Vendos një kryq ose pranë PO-së ose pranë JO-së në çdo rresht. Të përkthyer në shqip, janë këto dhoma për të cilat ti duhet të përgjigjesh nëse përdoruesi i karrocës së invalidëve mund ti përdorë ose jo:

- ◆ Banja.
- ◆ Tuelalet.
- ◆ Së paku një nga dhomat.
- ◆ Kuzhina.
- ◆ Dhoma e ndenjes.

### 21 Çfarë lloj sobash ose sistemesh për ngrohje ka banesa jote? Këtu ti mund të vendosësh disa kryqe.

Vendos një kryq në rreshtat e duhur të formularit. Të përkthyer në shqip, janë këto alternativa për përgjigje:

- ◆ Radiator elektrik i vendosur në mur, kablo ngrohjeje elektrike nën dysheme ose soba të tjera elektrike.
- ◆ Radiatorë me ujë ose ngrohje me anë të ujit nën dysheme.
- ◆ Oxhak i hapur.
- ◆ Oxhak i mbyllur ose soba të tjera me qymyr ose çdo lloj tjetër lënde djegëse të ngurtë.
- ◆ Oxhak ose soba të tjera me vajgur, naftë ose çdo lloj tjetër lënde djegëse të lëngshme.
- ◆ Pompë ngrohjeje.
- ◆ Mënyrë tjetër- trego se cilën.

### 22 A ka banesa ngrohje qendrore ose a është e lidhur ajo me një impiant të ngrohjes qendrore?

Vendos një kryq pranë PO-së së sipërme, në qoftë se banesa ka ngrohje qendrore. Nëse jo, atëherë vendos një kryq nën JO-në. Vendos një kryq pranë PO-së së poshtme në qoftë se banesa është e lidhur me një impiant të ngrohjes qendrore. Në qoftë se jo, atëherë vendos një kryq nën JO-në.

### 23 Cili burim energjie përdoret për të ngrohur banesën? Këtu ti mund të vendosësh disa kryqe.

Vendos një kryq në rreshtat e duhur të formularit. Të përkthyer në shqip, janë këto alternativa për përgjigje:

- ◆ Energji elektrike.
- ◆ Dru, tallash, qymyr, ose çdo lloj tjetër lënde djegëse të ngurtë.

- ◆ Vajgur, naftë, ose çdo lloj tjetër lënde djegëse e lëngshme.
- ◆ Gaz.
- ◆ Energji diellore.
- ◆ Burime të tjera energjie- trego cilat.
- ◆ Nuk e di.

### 24 Sa W.C. ka në banesën tënde?

Në qoftë se banesa jote nuk ka W.C., atëherë vendos një kryq në rreshtin e sipërm pranë ASNJË. Në qoftë se banesa ka nevojtoje, atëherë shkruaj në rreshtin e fundit numrin e W.C.

### 25 Me çfarë lloj kanalizimi të ujrave të zeza është e lidhur banesa jote?

Vendos një kryq në rreshtin e duhur të formularit. Përkthyer në shqip, janë këto alternativa për përgjigje:

- ◆ Rrjetin publik të ujrave të zeza.
- ◆ Rrjet privat të ujrave të zeza, vetëm për banesën time.
- ◆ Rrjet privat të ujrave të zeza që i shërben disa banesave.
- ◆ Nuk është e lidhur tek ndonjë lloj rrjeti të ujrave të zeza.
- ◆ Nuk e di.

### 26 Janë kryer përmirësime ose riparime të mëdha që nga koha kur banesa u përgatit për banim?

Në qoftë se nuk janë kryer përmirësime ose riparime të mëdha pasi që banesa u përgatit për banim, vendos një kryq sipër në kolonën e majtë (pranë JO-së). Në qoftë se janë kryer përmirësime ose riparime, vendos një kryq pranë PO-së, dhe trego me kryq edhe se kur u kryen këto përmirësime/riparime (në kolonën në të djathtë). Të përkthyer në shqip, janë këto alternativa për përgjigje:

- ◆ 1970 ose më herët.
- ◆ 1971-1980.
- ◆ 1981 ose më vonë.

Në qoftë se ti nuk e di nëse janë kryer përmirësime ose riparime të mëdha në banesë, atëherë vendos një kryq poshtë në kolonën e majtë.

### 27 A ke mundësi ti të përdorësh ...

Këtu ti do të vendosësh një kryq ose tek PO-ja ose tek JO-ja në çdo rresht. Përkthyer në shqip, ti duhet të përgjigjesh nëse ti ke të drejtë të përdorësh:

- ◆ Oborri tënd.
- ◆ Oborr të përbashkët me komshinjtë.
- ◆ Ballkon, verandë ose terracë tënden.

Pastaj ti duhet të përgjigjesh nëse banesa ka:

- ◆ Garazh ose vend parkimi të mbuluar të vetin.
- ◆ Vend të vetin për parkim.

Në faqen e fundit të formularit janë disa pyetje në lidhje me anëtarët e tjerë të familjes që banojnë me ty.

**28** Anëtarët e familjes tuaj që janë treguar më poshtë, janë regjistruar në Regjistrin themeltar të gjendjes civile me të njëjtën adresë me tënden.

**a) Ne dëshirojmë të dimë se cilët prej tyre banonin në banesën për të cilën ti je përgjigjur në këtë pyetësor, me datë 3 nëntor 2001.**

b) Për ata që banonin në një vend tjetër në këtë datë: **Ne do të dëshironim të dinim nëse ata banonin në një banesë tjetër, ose nëse ata banonin në repart ushtarak, spital, azil pleqsh ose në një institucion tjetër.**

Këtu ti duhet të vendosësh një kryq për çdo anëtar të familjes. Pas emrave që tregohen në formular, ti duhet të vendosësh një kryq në kolonën e parë (a) në qoftë se ata banonin me datë 3 nëntor 2001, në banesën për të cilën ju jeni përgjigjur në formular. Në qoftë se ata banonin në një banesë tjetër, atëhere ti duhet të vendosësh një kryq në kolonën e dytë. Në qoftë se ata banonin në repart ushtarak, në spital, në azil pleqsh ose në një institucion tjetër, atëhere ti duhet të vendosësh një kryq në kolonën e tretë.

**29 A ka persona të tjerë që me datë 3 nëntor 2001, banonin në banesën për të cilën ti je përgjigjur, por që nuk janë në listën e pyetjes 28?**

Në qoftë se PO, atëhere ti duhet ti përgjigjesh pyetjes 30.

Në qoftë se JO, atëhere ti e ke përfunduar plotësimin e formularit. Ju lutemi të na e dërgoni mbrapsht në zarfin e përgjigjes që ju është dërguar së bashku me formularin. Faleminderit për kontributin e dhënë!

**30 Shkruaj emrin, mbiemrin, ditëlindjen, dhe çfarë lidhjeje keni ju me këta persona.**  
PËRDOR SHKRONJA TË MËDHA  
SHTYPI

Ti duhet të shkruar emrin në rreshtin e parë, mbiemrin duhet ta shkruash në rreshtin e dytë, në vendet e mëposhtme. Ti duhet të shkruash datëlindjen sipas kësaj rradhe: Ditë- muaj- vit. Ti duhet të vendosësh një kryq po ashtu, në kolonën e parafundit në qoftë se ti bashkëjetoje me këtë person me datë 3. nëntor.

Tani ti e ke përfunduar plotësimin e formularit. Ju lutemi të na e dërgoni mbrapsht në zarfin e përgjigjes që ju është dërguar së bashku me formularin. Faleminderit për kontributin e dhënë!